



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 4.1, nenit 39. 1 të Rregullores së UNMIK – ut mbi Vetqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000 /45, Udhëzimit administrativ 2001-02 – 03 të lëshuara bashkarisht nga Departamenti i Administratës Lokale dhe Autoriteti Qendror Fiskal, për implementimin e kësaj Rregullore, Statutit të Komunës së Prishtinës nenit 19, 40, 58, 84 dhe 86, dhe Rregullores mbi tarifat dhe ngarkesat Komunale nr. 01/413-523, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjene mbajtur më datë _____ miraton këtë :

Propozim
RREGULLORE PËR LËSHIMIN E LEJEVE TË PUNËS PËR
SUBJEKTET AFARISTE

Dispozitat e përgjithëshme

Neni 1.

- 1.1 Emërtimi Subjekt afarist sipas kësaj Rregullore nënkupton çfarëdo Subjekti afarist që merret me aktivitete ekonomike të mbështetura në ligj me qëllim përfitimi.
- 1.2 Të gjitha aktivitetet afariste ekonomike në Komunë të Prishtinës duhet të kryhen në vend të caktuar dhe të përshtatshëm me emërtimin “Lokal afarist”
- 1.3 Asnji lokal afarist nuk lejohet sipas kësaj Rregullore të ushtrojë veprimtarinë e vet afariste pa leje pune pune të lëshuar nga Drejtorati për Ekonomi.

Neni 2

- 2.1 Subjekti afarist që ushtron afarizmin në Komunën e Prishtinës duhet të jetë i rexhistruar sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr.2000 / 8 dhe në bazë të udhëzimeve tjera administrative të lëshuara nga ana e UNMIK-ut.

- 2.2 (i) Çdo person që ushtron biznes në ose nga lokalet të cilat janë të specifikuar në lejen e vlefshme komunale të biznesit të cilat gjenden Brenda kufijve të Komunës së Prishtinës.
- (ii) Një leje e ndarë duhet të merret në lidhje me çdo lokal në ose prej të cilit është duke u ushtruar biznesi.
- (iii) Çdo leje e lëshuar në pajtim me këto dispozita do të konsiderohet si leje personale e zotëruesit të lejes dhe nuk do të jetë e transferueshme për ndonjë person tjetër.
- (iv) Çdo person, duke qenë zotërues i lejes jo-banesore komunale të biznesit duhet të ushtrojë biznesin në ose nga lokalet që gjenden brenda kufijve të Komunës.

Neni 3

- 3.1 Subjekti afarist i cili i plotëson kushtet sipas nenit 1 dhe 2 të kësaj Rregullore është i obliguar të bëjë kërkesë për lëshimin e Lejes për punë afariste në biznese në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të kësaj Rregullore.
- 3.2 Aplikacioni duhet të jetë i kompletuar nga pronari i biznesit ose ndërmjetësuesi i autorizuar, në rast të ndonjë partnershipi ose pronarëve të shumëfishtë, secili prej pronarëve të tillë ose partnerëve të tillë mund të aplikojnë dhe të gjithë pronarët ose partnerët të cilët aplikojnë duhet të merren si të vetmit përfaqësues të autorizuar të të gjithë pronarëve ose partnerëve.

Neni 4

Subjekti afarist pas aplikimit të kërkesës për lëshimin e Lejes për punë afariste në biznese obligohet që brenda afatit prej 15 ditësh të plotëson kërkesën e vet me dokumentacionin e duhur dhe atë:

- 4.1 Çertifikatën origjinale të rexhistrimit të biznesit të subjektit afarist dhe njësisive të sajë, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/8.
- 4.2 Lejen ndërtimore të lokalit afarist.
- 4.3 Dokumentet që e dëshmojnë pronësinë e lokalit afarist ose kontratën për marrjen me qira të lokalit afarist (vetëm për qiramarrësin) të vërtetuar në Gjykatën komunale të Prishtinës.
- 4.4 Proçesin nga Drejtorati i inspektionit për plotësimin e kushteve minimale teknike sanitare të lokalit afarist.
- 4.5 Kushtet e duhura shëndetësore – sanitare dhe kushtet tjera të punës që kërkohen me ligjet e aplikueshme dhe Rregulloret tjera Komunale.

- 4.6 Dëshmin mbi pagesën e kistit të pare ose të dy kisteve për lëshuarjen e Liçencës në biznese sipas Rregullores për Tarifat dhe Ngarkesat Komunale nr.01/413 – 523.
- 4.7 Detajet e të gjitha aktiviteteve të biznesit të ndërmarra ose që kërkohen të ndërmerren nga aplikanti për leje biznesi.
- 4.8 Skicën (projektin) e lokalit ku do të ushtrohet biznesi me sipërfaqe të përgjithëshme në m².

Neni 5

Leja për punë afariste vlen një vit nga data e lëshuarjes.

Neni 6

Ripërtërirja e Lejes për punë afariste për vitin vijues bëhet vetëm në bazë të kërkesës dhe pas pagesës sipas Rregullores mbi arifat dhe ngarkesat komunale për lokalet të cilat nuk e kanë ndërruar destinimin dhe adresën e afarizmit – lokalit afarist.

Kërkesa si në paragrafin 1 të këtij neni duhet të bëhet brenda 15 ditësh, nga dita e skadimit të afatit njëvjeçar.

Neni 7

Çdo ndryshim në emërtimin e biznesit apo ndrrimin e adresës së subjektit afarist që ndodh pas dorëzimit të kërkesës për dhënjen e lejes për punë apo pas marrjes së Lejes për punë të bizneseve , pronari është i obliguar të lajmrojë Drejtoratin për Ekonomi në afat prej 7 ditësh nga dita e ndryshimeve të ndodhura.

Neni 8

Drejtorati për Ekonomi është i obliguar që brenda afatit prej 30 ditësh të njoftoj subjektin afarist për ndryshimet e bëra sipas kërkesës së tij.

Neni 9

Pronari i biznesit është i obliguar që në njësinë ekonomike (lokalet afariste) të zhvillojë aktivitetin ekonomik nën këto kushte:

- 9.1 Leja e vlefëshme e punës duhet të ekspozohet në çdo lokal biznesi në një vend të dukshën dhe në çdo kohë.
- 9.2 Të vendos çmimet e produkteve (mallrave) në mënyrën më të lehtë për lexim.
- 9.3 Të lëshojë fakturë për mallrat e shitura ose për shërbimet e bëra ndaj konsumatorëve.
- 9.4 Të ekspozojë në vend të dukshëm për konsumator orarin e punës sipas Rregullores komunale mbi fillimin dhe mbarimin e orarit të punës.

Dispozitat përfundimtare

Neni 10

Çdo Subjekt afarist dhe çdo pronar i biznesit i cili do të punojë në kundërshtim me këtë Rregullore, rregulloret tjera të UNMIK-ut dhe me ligjet e aplikueshme për veprimtaritë biznesore do të ndëshkohet me dënime mandatore :

10.1 Poqëse nuk ka bërë kërkesë për Leje pune dhe vazhdon afarizmin pa leje pune me dënim prej 100 €

10.2 Poqëse pronari i biznesit edhe pas aplikimit të masave sipas pikës 10.1 vazhdon të zhvillojë biznesin në kundërshtim me këtë Rregullore, Drejtorati për Ekonomi do të marrë vendim për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së atij biznesi.

10.3 Leja e punës mund të suspendohet në çfardo rrethana tjera të përshkruara nga ligji i zbatueshëm.

Neni 11

Leja për punë mund të përdoret vetëm për destinimin e dhënë.

Neni 12

Leja e punës është e pavlefshme :

12.1 Kur Subjekti afarist e ndërpren aktivitetin dhe bënë kërkesë për çrexhtrim.

12.2 Pas një viti nga data e lëshuarjes së Lejës për punë.

12.3 Në rast se Komuna lëshon Leje për një aktivitet biznesi ose komercial të paligjshëm.

Neni 13

Për implementimin e kësaj Rregullore përgjegjës është Drejtorati për Ekonomi dhe Drejtorati i Inspektionit.

Neni 14

Asgjë nga kushtet e kësaj Rregullore komunale nuk do ta ndaloj secilin person të goditur nga kushtet e saj për të kërkuar dëmshpërblim nga një trup kompetent ose gjykatë kompetente.

Neni 15

Rregullorja hynë në fuqi në ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

Nr. _____ Data _____

KRYETARI I KUVENDIT

Dr. Salih Gashi